



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SH.A
DIVIZIONI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Data 08.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje sistem PAM (Zgjidhje për autentifikim të thelluar për përdoruesit administrativ) Privileged Access Management”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV — 48732000-8 (Paketa software për siguri të dhënash) dhe 48000000-8 (Paketa software dhe sisteme informacioni);

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,350,416.67 (shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Identitek” Sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose versione të përditësuara/ekuivalente), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 27001:2022** (ose versione të përditësuara/ekuivalente), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 20000-1:2018** (ose versione të përditësuara/ekuivalente), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Argumentimi teknik: Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- ISO 9001 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) është certifikatë e zakonshme dhe zakonisht konsiderohet e arsyeshme për operatorët ekonomikë që ofrojnë zgjidhje dhe shërbime IT.
- ISO 27001 (Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit) është shumë e lidhur me objektin e kontratës, pasi sistemi do të përpunojë dhe monitorojë trafikun e rrjetit, mund të trajtojë çështje të sigurisë kibernetike.
- ISO 20000-1 (Menaxhimi i Shërbimeve IT) mund të justifikohet nëse kontrata përfshin instalim, konfigurim, mirëmbajtje, suport teknik ose shërbime të vazhdueshme IT.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 3 (tre) punonjës të kualifikuar dhe certifikuar për realizimin e këtij shërbimi, si vijon.

a) 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente (Cobit, eTOM, etj.) me profil Teknologji Informacioni ose Informatik Ekonomike ose Administrim Biznesi ose Shkenca Kompjuterike.

b) 1 (një) Specialist/Inxhinier për implementimin e sistemit PAM, me profil Teknologji Informacioni ose Informatik Ekonomike ose Shkenca Kompjuterike.

c) 1 (një) punonjës specialist IT, me profil Teknologji Informacioni ose Informatik Ekonomike ose Shkenca Kompjuterike.

➤ Për stafin e sipër cituar, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Listën emërore të stafit;
- Kontratat e punës ose marrëveshjen e angazhimit për këtë procedurë prokurimi, për secilin;
- Diplomën universitare dhe CV për secilin.
- Certifikimet përkatëse, për secilin.

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, operatorët ekonomik duhet të paraqesin Certifikatat përkatëse të lëshuara nga **“Vendori/ Prodhuesi” ose Institucione të autorizuar Akredituese dhe standardizuese** (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

Shënim:

Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për ti dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesa.

Argumentimi ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri do të arrihet të sigurohet ekipi i duhur në fushën e objektit të prokurimit duke siguruar staf të kualifikuar. Ky kriter është vendosur duke u nisur nga rëndësia e këtij projekti, i cili përveç veprimtarisë funksionale të tij

ka impakt të drejtëperdrejtë në një numër shumë të lartë sistemesh të tjera të cilët ofrojnë shërbime për qytetarët.

Argumentimi teknik: Një certifikim **ITIL ose ekuivalente** është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik garanton perfundimin e projektit sipas standardeve ndërkombëtare të njohura. Kërkesa për një punonjës të certifikuar në projekt garanton cilësi dhe standardizim të shërbimeve, duke siguruar që proceset të jenë të strukturuar, të dokumentuara dhe të matshme. Kjo rrit cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara ndaj institucionit publik. Këto korniza përfaqësojnë praktikën më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve IT, duke siguruar që proceset të jenë të strukturuar, të dokumentuara dhe të matshme. Kjo rrit cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara.

Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme vendosjen e kriterit që operatori ekonomik të disponojë në stafin e tij ose të ketë të angazhuar të paktën **1 (një) Specialisti/Inxhinieri për implementimin e sistemit PAM (Privileged Access Management)** është e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të implementimit, konfigurimit dhe vënies në funksion të sistemit, në përputhje me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor. Sistemet PAM janë zgjidhje kritike të sigurisë kibernetike, të cilat menaxhojnë, kontrollojnë dhe monitorojnë akseset me privilegje të larta në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit. Implementimi i tyre kërkon njohuri të specializuara në administrimin e sistemeve operative, shërbimeve të direktorive (p.sh. Active Directory), menaxhimin e identiteteve, autentikimin shumëfaktorësh (MFA), protokollet e komunikimit, integrimin me aplikacione dhe sisteme të tjera të sigurisë, si dhe zbatimin e praktikave më të mira të sigurisë së informacionit.

Specialisti/Inxhinieri i implementimit do të jetë përgjegjës për:

- instalimin dhe konfigurimin e platformës PAM;
- integrimin e sistemit me infrastrukturën ekzistuese të Autoritetit Kontraktor;
- konfigurimin e politikave të aksesit të privilegjuar, kasafortës së kredencialeve (credential vault), menaxhimit të sesioneve dhe mekanizmave të auditimit;
- testimin e funksionaliteteve dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave teknike;
- migrimin e konfigurimeve dhe asistencën gjatë kalimit në mjedisin e prodhimit;
- zgjidhjen e problematikave teknike gjatë implementimit dhe ofrimit e mbështetjes teknike fillestare.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë të paktën **1 (një) Specialist/Inxhinier për implementimin e sistemit PAM**, me formim universitar në Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Informatike ose fusha të ngjashme, si dhe me kualifikime dhe eksperiencë profesionale në implementimin e zgjidhjeve PAM ose sistemeve të avancuara të sigurisë kibernetike. Ky kriter siguron që implementimi të kryhet nga personel i kualifikuar, duke minimizuar rreziqet teknike, duke garantuar funksionimin korrekt të sistemit dhe duke përmbushur objektivat e kontratës në aspektin e sigurisë, cilësisë dhe afateve të realizimit.

Specialist IT është i nevojshëm për të mbështetur procesin e implementimit, për të kryer konfigurimet teknike në infrastrukturën ekzistuese, për të asistuar në integrimin me sistemet e tjera të teknologjisë së informacionit, si dhe për të garantuar ofrimin e mbështetjes teknike gjatë fazës së vendosjes në punë dhe periudhës së garancisë ose mirëmbajtjes së zgjidhjes. Kërkesa për një specialistë IT siguron disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme njerëzore për realizimin e kontratës brenda afateve të parashikuara, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe reduktimin e rreziqeve që mund të lindin nga mungesa e stafit teknik të kualifikuar.

Ky kriter konsiderohet proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, si dhe i nevojshëm për të verifikuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se garanton mbështetje teknike gjatë gjithë periudhës së licencimit si dhe akses në përditësimet e sigurisë dhe versionet e reja;

Argumentimi teknik: *Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë se garanton mbështetje teknike gjatë gjithë periudhës së licencimit, si dhe akses në përditësimet e sigurisë dhe versionet e reja, është një kërkesë thelbësore për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm, të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit PAM (Privileged Access Management).*

Sistemet PAM janë komponentë kritikë të infrastrukturës së sigurisë kibernetike dhe administrojnë llogaritë me privilegje të larta, të cilat përbëjnë objektivat kryesore të sulmeve kibernetike. Për këtë arsye, është e domosdoshme që sistemi të përditësohet vazhdimisht me korrigjimet e dobësive të sigurisë (security patches), përmirësimet funksionale dhe versionet e reja të publikuara nga prodhuesi.

Mbështetja teknike gjatë gjithë periudhës së licencimit garanton ndërhyrje të specializuara në rast të problematikave teknike, asistencë për konfigurime, zgjidhjen e incidenteve, si dhe ruajtjen e disponueshmërisë dhe performancës së sistemit. Gjithashtu, aksesit në përditësimet e sigurisë dhe versionet e reja siguron mbrojtje ndaj kërcënimeve të reja kibernetike, përmirëson stabilitetin dhe funksionalitetet e platformës, si dhe garanton përputhshmërinë me ndryshimet teknologjike dhe sistemet e tjera të infrastrukturës së Autoritetit Kontraktor. Për këtë arsye, deklarimi i operatorit ekonomik për garantimin e mbështetjes teknike dhe aksesit në përditësimet e sigurisë dhe versionet e reja gjatë gjithë periudhës së licencimit është një kërkesë e domosdoshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit, mbrojtjen e aseteve kritike të informacionit dhe realizimin me sukses të objektivave të kontratës. Ky kriter është në përputhje me parimet e mirëadministrimit të sistemeve të sigurisë së informacionit dhe garanton investimin afatgjatë të Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 21.07.2026; Ora: 11:00;
Vendi: “IdentiTek” Sh.A, Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.